



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 85

Tiranë – E hënë, 5 qershor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 172, datë 18.5.2023	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së “Alpex” sh.a. lidhur me komitetin e Bursës Shqiptare të Energjisë..... 9401
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 173, datë 18.5.2023	Mbi disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 164/2016..... 9402
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 174, datë 18.5.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike... 9404
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 175, datë 18.5.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.... 9406
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 176, datë 18.5.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Erseka Solar park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës..... 9407
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 177, datë 18.5.2023	Mbi modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, i ndryshuar..... 9408
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 178, datë 18.5.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’, me kapacitet të instaluar 1.730 mw”, i ndryshuar..... 9409
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 6, datë 2.6.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH..... 9410
Kërkesë e Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin nr. 351/7, datë 2.6.2023	Për disa shtesa në VKM- në nr. 769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Unaza Lindore Tiranë, loti III’, shtesat” 9412

**VENDIM****Nr. 172, datë 18.5.2023****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË ALPEX
SHA LIDHUR ME KOMITETIN E
BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 16, 18, pika 1, germa “a” dhe “dh”; nenit 19 germa “a”, neneve 57 dhe 98 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikave B. 2.2 , B. 3.3.1 dhe B.3.3.2 të “Rregullave të tregut të energjisë elektrike, kushtet e përgjithshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022; si dhe neneve 19 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës, me nr. 1300/1 prot., datë 17.5.2023, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së ALPEX sh.a. lidhur me Komitetin e Bursës Shqiptare të Energjisë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi të miratojë “Rregullat e tregut të energjisë elektrike” (kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe të shlyerjes).

- Shoqëria ALPEX sh.a., me shkresën nr. 128 prot., datë 19.4.2023, protokolluar me tonën me nr. 1300 prot., datë 24.4.2023, ka paraqitur për miratim procedurën e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë.

- Në pikat B.2.2, B.3.3.1 dhe B.3.3.2, germa “a” të “Aspekteve ligjore dhe të qeverisjes, të kushteve të përgjithshme të Rregullave të tregut të energjisë elektrike”, përcaktohen ndër të tjera roli i Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë, si dhe përgjegjësia e ALPEX sh.a. për hartimin, përditësimin dhe paraqitjen për miratim pranë autoriteteve rregullatore të procedurës së Komitetit të Bursës.

- Procedura e paraqitur për miratim nga shoqëria ALPEX sh.a. përbëhet nga tetë kapituj, shtojca A me anëtarët e Komitetit fillestar të Bursës si dhe aplikimi për anëtarësim dhe pjesëmarrje në këtë Komitet.

- Ngritja e Komitetit të Bursës, si një organ konsultativ i zgjedhur nga anëtarët e Bursës është i nevojshëm për promovimin e “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”, që ato të mbeten aktuale dhe të përditësuara me kalimin e kohës, nëpërmjet konsultimit dhe këshillimit me ALPEX-in për ndryshimin e “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”.

- Në pikën B.2.3.1 të rregullave, “Përbërja e Komitetit të Bursës”, përcaktohet se komiteti duhet të pasqyrojë llojshmërinë e anëtarëve të Bursës, sipas tipit të licencave që anëtarët e Bursës zotërojnë. Ndërsa në pikën B.2.3.2 përcaktohet se Komiteti i Bursës do të përbëhet nga jo më shumë se 10 (dhjetë) anëtarë, ku 8 (tetë) anëtarë janë të zgjedhur nga anëtarët e Bursës dhe dy anëtarë janë të emëruar nga ALPEX-i, ku njëri prej të cilëve do të jetë kryetari i Komitetit.

- Sikurse evidentuar dhe më sipër ky komitet ka një rol konsultativ për ALPEX sh.a. dhe në fazën fillestare të operimit të ALPEX që prej datës 11.4.2023, roli konsultativ i komunitetit mund të ketë ndikim pozitiv në operimin e bursës dhe në bërjen e propozimeve nëse është e nevojshme për përmirësimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së shoqërisë ALPEX sh.a. lidhur me procedurat e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.



Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi**

**VENDIM
Nr. 173, datë 18.5.2023**

**MBI DISA NDRYSHIME NË
KONTRATËN TIP MBI VERIFIKIMIN E
MATËSVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
DHE VULOSJEN E TYRE, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË ERE-s NR. 164/2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 77, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”; të “Kodit të Matjes”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 101, datë 26.8.2008; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 994/3 prot., datë 17.5.2023, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 164/2016”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 13.3.2023, vendosi fillimin e procedurës për disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 164/2016. Vendimmarrja e mësipërme u mbështet në kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., i cili me shkresën nr. 2136 prot., datë 1.3.2023, protokolluar në ERE me nr. 994 prot., datë 3.3.2023, kërkoi ndryshime në kontratën tip të sipërcituar.

- ERE, me shkresën nr. 1090 prot., datë 20.3.2023, njoftoi hapjen e procesit të konsultimit publik duke adresuar kërkesën për opinione dhe qëndrime të palëve të interesit.

- Në vijim të hapjes së procesit të konsultimit publik, në ERE janë dërguar komente nga këto

palë interesi: Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), shoqëria HTT sh.p.k. dhe shoqëria VME sh.p.k.

- ERE, me qëllim diskutimin me palët e interesit, në lidhje me propozimet e OSSH sh.a., mbi të cilat u fillua procedura për disa ndryshime në kontratën tip të miratuar me vendimin e Bordit nr. 164/2016, organizoi një seancë dëgjimore më datë 18.4.2023, me përfaqësues nga ERE, DPM, OSSH sh.a., HTT sh.p.k. dhe VME sh.p.k., të cilët parashtruan propozimet e tyre, në lidhje me kërkesat e OSSH sh.a., për ndryshimin e kontratës tip të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 164/2016.

- Duke marrë në konsideratë qëndrimet e palëve në lidhje me nenin 12.2, pikën 1 të kontratës tip, vlerësojmë se: legjislacioni në fuqi, konkretisht ligji nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, nuk parashikon në asnjë dispozitë kompetencën e DPM-së si organi që “harton apo miraton” planin grafik vjetor të ndarë sipas muajve dhe rajoneve. Për më tepër, neni 39, pika 4, e ligjit të sipërcituar, parashikon se: “Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të miratohet rregulloren për kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe për monitorimin e aktivitetit/performancës së tyre në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.”.

- Në këto kushte dhe në përputhje me parashikimet ligjore të sipërcituara, vlerësojmë që në kontratën tip të ndryshohet neni 12, pika 12.2.1 si vijon: “Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligj, të hartohet planin grafik vjetor (të ndarë sipas muajve dhe sipas rajoneve) të shërbimeve, duke siguruar që brenda afateve për verifikimin periodik, të përcaktuar në Kodin e Matjes, të verifikohen të gjithë matësit elektrik në përdorim. Pjesa e shërbimeve që lidhen me verifikimin fillestar të matësve elektrikë; verifikimin e matësit elektrik sipas ankesave të klientëve ose verifikimin sipas kërkesave të operatorit të rrjetit për anomali të identifikuar nga ana e tij, nuk janë pjesë e këtij planifikimi.”.

- Në të njëjtin kapitull të kontratës neni 12, pika 12.2.16, parashikon se: “Mban përgjegjësi për realizimin e planit mujor të shërbimeve të miratuar nga DPM-ja dhe nëse për një periudhë të caktuar



kohe plani mujor nuk realizohet, atëherë mosrealizimi do të plotësohet në muajin në vazhdim.”. Për rrjedhojë të ndryshimeve të sipërcituara, ku plani “grafik vjetor” i ndarë sipas muajve dhe rajoneve duhet të përcaktohet sipas dhe në mbështetje të përcaktimeve ligjore të sipërcituara, vlerësohet e nevojshme ndryshimi i nenit 12, pikës 12.2.16, si vijon: “Mban përgjegjësi për realizimin e planit mujor të shërbimeve dhe nëse për një periudhë të caktuar kohe plani mujor nuk realizohet, atëherë mosrealizimi do të plotësohet në muajin në vazhdim.”.

- Këto ndryshime të kontratës tip, lidhen edhe me ndryshimet e mundshme ligjore sipas përcaktimeve të nenit 39, të ligjit “Për metrologjinë”, ku ndër të tjera përcaktohet se është ministria autoriteti i cili do të nxjerrë aktet respektive, në lidhje me: kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe për monitorimin e aktivitetit/performancës..., vlerësojmë se në këtë kuptim duhen rishikuar edhe dispozitat 21.1, 21.2 dhe 21.7 si vijon:

“21.1 Palët janë përgjegjëse për zbatimin e planit vjetor të shërbimeve objekt i kësaj kontrate.

21.2 Operatori i rrjetit mban përgjegjësi për krijimin e kushteve dhe realizimin e programit të punës. Nëse programi i punës nuk do të realizohet brenda një muaji të caktuar të vitit, atëherë diferenca do të realizohet në muajin pasardhës.

21.7 Shërbimet do të kryhen në laborator dhe në terren. Subjekti i autorizuar do të kryejë shërbimet në rajonet dhe agjencitë sipas ndarjes së zonave gjeografike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”. Në kapitullin XXVI, pika 26.1 e kontratës tip parashikon se: “Kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet nga data e nënshkrimit të saj dhe jo më shumë se 3 (tre) vjet, me të drejtë përsëritje. Nëse operatori i rrjetit nuk njofton me shkrim kontraktorin një muaj përpara përfundimit të afatit dyvjeçar, kontrata konsiderohet e rinovuar automatikisht edhe për një vit tjetër”; dhe në vijim, në pikën 26.2 parashikohet se: “Pas mbarimit të këtij afati palët kanë të drejtë të nënshkruajnë një kontratë të re në zbatim të ligjit. Një muaj përpara mbarimit të kësaj kontrate, palët fillojnë negociatat për rinovimin e saj.”.

- Ndërkohë, në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 77 “Verifikimi i matësve”, pika 1, parashikon se: “Verifikimi i matësve të energjisë elektrike kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose nga një person juridik i autorizuar prej saj. Personi juridik i autorizuar për këtë qëllim akreditohet sipas legjislacionit në fuqi.”. Ndërsa në pikën 10, të nenit 77, përcaktohet se: “ERE miraton kontratën tip ndërmjet operatorit të sistemit dhe DPM-së ose subjektit të autorizuar nga ana e saj për verifikimin e matësve.”.

- Për sa cituar më sipër dhe në tërësi, rezulton se në asnjë dispozitë të ligjit nr. 43/2015, nuk është parashikuar kohëzgjatja e “Kontratës tip mbi verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë”. Në këtë kuptim, kohëzgjatja e kontratës, objekt i rishikimit, nuk pengon realizimin e verifikimit të matësve sipas përcaktimeve ligjore të lartpërmendura. Për më tepër, ulja e kohëzgjatjes krijon mundësi për integrimin e subjekteve të reja të cilët autorizohen për kryerjen e verifikimit dhe vulosjes së matësve elektrikë.

- Ligji nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, gjithashtu nuk parashikon në asnjë dispozitë një afat kohor për kohëzgjatjen e kontratës tip, objekt i kësaj procedure. Duke marrë në konsideratë se një afat tre(2+1)-vjeçar, i parashikuar në kontratën tip është një pengesë kontraktuale, vlerësojmë se mund të bëhet pengesë për liberalizmin e tregut për verifikimin e matësve për sa parashikuar edhe në nenin 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ku ndër të tjera parashikon se: “..... vendos rregullat lidhur me: a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike.”. Në këto kushte vlerësojmë ndryshimin e pikës 26.1, në kapitullin XXVI të kontratës tip.

- Në lidhje me pikën 31.2, të kontratës tip ku parashikohet se: “Aneksat krijohen në dakordësi të palëve. Aneksat mund të ndryshohen, duke rënë dakord me shkrim nga palët, pa kërkuar miratim nga ERE. Aneksat asnjëherë nuk tejkalojnë përmbajtjen e kërkesave të përgjithshme”; vlerësojmë se çdo ndryshim i kontratës duhet të miratohet nga ERE, përfshirë por pa u kufizuar edhe në anekset e saj meqenëse ato janë pjesë përbërëse e kontratës tip. Për pasojë lind nevoja për shfuqizimin e pikës 31.2 dhe rirenditjen e pikave në kuadër të ndryshimit të vlerësuar.



- Në kuptim të ndryshimit, për sa sqaruar dhe më lartë, është e domosdoshme edhe përshtatja e aneksit nr. 2 të kontratës, në përputhje me ndryshimet e sqaruara më lartë, duke përshtatur terminologjinë e përdorur.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në kontratën tip mbi verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 164/2016.

2. Kapitulli XXII, neni 12.2, pika 1 dhe pika 16, ndryshohet dhe bëhet:

“12.2.1 Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligj, të hartojë planin grafik vjetor (të ndarë sipas muajve dhe sipas rajoneve) të shërbimeve, duke siguruar që brenda afateve për verifikimin periodik, të përcaktuara në Kodin e Matjes, të verifikohen të gjithë matësit elektrik në përdorim. Pjesa e shërbimeve që lidhen me verifikimin fillestar të matësve elektrikë; verifikimin e matësit elektrik sipas ankesave të klientëve ose verifikimin sipas kërkesave të operatorit të rrjetit për anomali të identifikuar nga ana e tij, nuk janë pjesë e këtij planifikimi.

....

12.2.16 Mban përgjegjësi për realizimin e planit mujor të shërbimeve dhe nëse për një periudhë të caktuar kohe plani mujor nuk realizohet, atëherë mosrealizimi do të plotësohet në muajin në vazhdim.”.

3. Kapitulli XXI, neni 21, pika 21.1, pika 21.2 dhe pika 21.7 ndryshojnë dhe bëhen:

“21.1 Palët janë përgjegjëse për zbatimin e planit vjetor të shërbimeve objekt i kësaj kontrate.

21.2 Operatori i rrjetit mban përgjegjësi për krijimin e kushteve dhe realizimin e programit të punës. Nëse programi i punës nuk do të realizohet brenda një muaji të caktuar të vitit, atëherë diferenca do të realizohet në muajin pasardhës.

....

21.7 Shërbimet do të kryhen në laborator dhe në terren. Subjekti i autorizuar do të kryejë shërbimet në rajonet dhe agjencitë sipas ndarjes së zonave gjeografike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

4. Kapitulli XXVI, neni 26, pika 26.1, ndryshon dhe bëhet:

“26.1 Kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë jo më pak se 1 (një) vit nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë përsëritje, vetëm me një afat tjetër 1-(një)-vjeçar. Nëse Operatori i rrjetit nuk njofton me shkrim kontraktorin një muaj përpara përfundimit të afatit 1-(një)-vjeçar, kontrata quhet e rinovuar automatikisht edhe për 1 (një) vit tjetër.”.

5. Në kapitullin XXXI, neni 31, pika 31.2, shfuqizohet. Renditja ndryshon dhe pika 31.3 bëhet pika 31.2, pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

6. Aneksi nr. 2 i kontratës ndryshohet dhe bëhet:

Aneksi 2 titullohet: Ndarja e rajoneve dhe agjencive: Subjekti i Autorizuar ____ NIPT ____:

7. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vend bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 174, datë 18.5.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10,



pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1378/1 prot., datë 17.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1378 prot., datë 8.5.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b” dhe “d” dhe për pikën 1.3, germat “a” dhe “b”.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, në format original ose fotokopje të njësuar me origjinalin, dokumentacionin si vijon:

- strukturën organizative;
- informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në gwh) të parashikuar për t’u furnizuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës;
- planin e biznesit;
- informacion mbi disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, me adresat përkatëse të vendndodhjes së tyre;
- informacion mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët;
- gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë informacion/dokumentacion në lidhje me kontratën e qirasë, duke saktësuar që afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate duhet të mbulojë të gjithë periudhën 5-vjecare të licencimit.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi, të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

**VENDIM****Nr. 175, datë 18.5.2023****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“PROINFINIT CONSULTING” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/1 prot., datë 17.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinet Consulting’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinet Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1379 prot., datë 8.5.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Proinfinet Consulting” sh.p.k., në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b” dhe “d” dhe për pikën 1.3, germat “a” dhe “b”.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE në format original ose fotokopje të njësuar me origjinalin:

- strukturën organizative;

- informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në gwh) të parashikuar për t’u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës;

- planin e biznesit.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të Rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Proinfinet Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi**



VENDIM

Nr. 176, datë 18.5.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ERSEKA SOLAR PARK 1” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAÏK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw, NË
ZONËN E ERSEKËS, BASHKIA
KOLONJË, QARKU I KORÇËS**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 884/12 prot., datë 17.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës”.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 64, datë 3.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 4.3.2023 dhe 5.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.4.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.

- Në vijim, duke qenë se nga ana e shoqërisë nuk ishte depozituar ende miratimi përfundimtar për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit, por shoqëria kishte bërë me dije në *email*-in e datës 27.4.2023 se pritej të merrte këtë miratim brenda 7 ditëve, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 156, datë 2.5.2023, vendosi të zgjasë deri në 20 ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar, në lidhje me licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me tej, me shkresën nr. 884/11 prot., datë 8.5.2023, shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. ka depozituar “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik ‘Erseka Solar Park 1’”, duke plotësuar tërësisht dokumentacionin e munguar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të rregullores së licencimit.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret shoqëria ka plotësuar në formatin e aplikimit se afati i pritshmërisë së centralit fotovoltaik është 35 vjet, ndërkohë rezulton se ka dokumentuar që garancia e tij është 30 vjet, ndaj në



këto rrethana ERE kushtëzohet nga kjo garanci dhe nga ligji nr. 43/2015, në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, për 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 177, datë 18.5.2023

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SHPK, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 13 dhe 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator

të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1011/1 prot., datë 17.5.2023, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 104, datë 20.3.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar, duke shtuar në këtë licencë dhe HEC “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw dhe kapacitet total të instaluar 14 962 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit në Bashkinë Mat, qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, qarku Lezhë.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.3.2023 dhe 23.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.4.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1011/5 prot., datë 3.3.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k. për këtë vendim dhe i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., duke i kërkuar të shprehin komentet apo opinionet e tyre, në lidhje me këtë procedurë, në rast se kanë të tilla.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1011/6 prot., datë 5.4.2023, AMBU-ja ka shprehur dakordësinë e saj, në lidhje me vendimmarrjen e ERE-s.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”: plotësuar.



- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj pagesave të rregullimit ndaj ERE-s dhe po ashtu ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të Rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar.

2. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar, pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtje si vijon:

“2. Të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “ZAIS”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, për një afat 28-vjeçar.”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi**

VENDIM

Nr. 178, datë 18.5.2023

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË
10.3.2022, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘LAJTHIZA INVEST’ SHA,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘QAMI 1’, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1.730 mw”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 70/7 prot., datë 17.5.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’ me kapacitet të instaluar 1.730 mw, i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 197, 3.8.2022”.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 40, datë 10.3.2022, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 197, datë 3.8.2022, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë me Bashkinë Kukës ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te kjo bashki, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune, duke filluar ky afat nga data 7.7.2022.

3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së saj, brenda datës 4.9.2022.



- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2 pas korrespondencës së gjatë dhe mbajtjes së një seance dëgjimore më datë 18.1.2023, me përfaqësues të shoqërisë, Bashkisë Kukës dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Zyrës Vendore (ASHKZV) Kukës, rezultoi se shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin përkatës pronësor që i jep të drejtën për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet në Bashkinë Kukës, duke plotësuar kështu dhe kushtin e kësaj pike, i cili vlerësohet të shfuqizohet.

- Në lidhje me kushtin e pikës 3 të vendimit të Bordit nr. 40/2022, të ndryshuar, që ka të bëjë me depozitimin e lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujor, shoqëria ka bërë me dije se ka aplikuar në datë 18.11.2022, aplikim i cili është konfirmuar edhe nga AMBU në shkresën me nr. 125/1 prot., datë 23.1.2023. ERE ka zhvilluar një korrespondencë të gjatë me AMBU-në dhe së fundi i është drejtuar dhe me shkresën nr. 1397 prot., datë 11.5.2023, në të cilën kërkon orientimin shterues nga ana e saj për mënyrën se si do t'i konsiderojë ERE këto subjekte. Në këto rrethana, vlerësojmë se ERE duhet të shprehet mbi këtë kusht, pasi organi përgjegjës i menaxhimit të burimeve ujore të përcaktojë në mënyrë shteruese orientimin e tij, për këtë arsye vlerësojmë t'i lejmë shoqërisë një afat 3-mujor për depozitimin në ERE të lejes së përdorimit të burimit ujor të rinovuar.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

"3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi."

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Lajthiza Invest" sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Faqe | 9410

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 6, datë 2.6.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhër urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 'Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror' në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 6, datë 2.6.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi Operativ, dosje formulare nr. 3125, në ngarkim të V.S., dosja daton në vitet 1979–1984,



me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Fondi Operativ, dosje agjenturalo-operative nr. 2646, me pseudonimin “Litari”, dosja daton në vitet 1959–1965, me 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

3. Fondi të Arratisur, dosje formulare nr. 1718, në ngarkim të M.P., me 12 (dymbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1955–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Fondi Operativ, dosje formulare nr. 268, në ngarkim të P.B., me pseudonimin “Bufi”, dosja daton në vitet 1959–1981, me 2 vëllime, me 379 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë) dhe 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Fondi Drejtoria II, dosje fashikull nr. 145, në ngarkim të I.K., me pseudonimin “Ciklopi”, dosja daton në vitet 1977–1990, me 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lezhë, dosje përpunimi nr. 1615, në ngarkim të P.M., dosja daton në vitet 1978–1989, me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Fondi Drejtoria II, dosje nr. 152, në ngarkim të L.G., dosja daton në vitet 1973–1987, me 409 (katërqind e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje formulare nr. 8057, në ngarkim të M.Gj., dosja daton në vitet 1959–1984, me 107 (njëqind e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

9. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje formulare nr. 8037, në ngarkim të A.K., dosja daton në vitet 1980–1984, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

10. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, dosje personale dhe pune nr. 233, në ngarkim të N.S. me pseudonimin “Zambaku”, dosja daton në vitet 1958–1990, me 3 volume me 50 (pesëdhjetë), 44 (dyzet e katër) dhe 324 (treqind e njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

11. Fondi Operativ, dosje formulare nr. 5989, në ngarkim të G.C., dosja daton në vitin 1986, me

174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

12. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, dosje personale dhe pune nr. 2851, në ngarkim të R.L. me pseudonimin “Trim”, dosja daton në vitet 1976–1988, me 39 (tridhjetë e nëntë) dhe 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

13. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, dosje personale dhe pune nr. 1209, në ngarkim të H.M., me pseudonimin “Vigilenti”, dosja daton në vitet 1970–1988, me 43 (dyzet e tre) dhe 421 (katërqind e njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

14. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, dosje personale dhe pune nr. 4644, në ngarkim të Sh.C., me pseudonimin “Letra”, dosja daton në vitet 1968–1990, me 61 (gjashtëdhjetë e një) dhe 129 (njëqind e njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

15. Fondi i Veçantë, dosje nr. 6279, në ngarkim të M.D me pseudonimin “Graniti”, dosja daton në vitet 1982–1988, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

16. Fondi Dega IV, dosje pune nr. 20839, me pseudonimin “Dajti”, dosja daton në vitet 1976–1980, me 2 vëllime, 742 (shtatëqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

17. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale nr. 201, në ngarkim të A.Q., me pseudonimin “Dajti”, dosja daton në vitet 1976–1991, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

18. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje pune nr. 201, me pseudonimin “Dajti”, dosja daton në vitet 1984–1989, me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) dhe 218 (dyqind e tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

19. Fondi Operativ, dosje nr. 2380, në ngarkim të S.Sh., dosja daton në vitet 1974–1980, me 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

20. Fondi Operativ, dosje pune dhe personale nr. 798, me pseudonimin “Gjallica”, dosja daton në vitet 1975–1976, me 205 (dyqind e pesë) 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) dhe 95 (nëntëdhjetë e pesë)



fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

21. Fondi i Veçantë, dosje personale dhe pune nr. 3013, në ngarkim të Sh.R., dosja daton në vitet 1983–1989, me 2 volume me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) dhe 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

22. Fondi Drejtoria II, dosje personale dhe pune nr. 1585, në ngarkim të S.R., me pseudonimin “Historiani”, dosja daton në vitet 1970–1990, me 2 volume me 325 (treqind e njëzet e pesë) dhe 235 (dyqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

23. Fondi i Veçantë, dosje personale dhe pune nr. 1735, në ngarkim të Z.C., me pseudonimin “Bilbili, dosja daton në vitet 1978–1990, me 3 volume me 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë + 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë në zarf, 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë dhe 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

24. Fondi të Arratisur, dosje nr. 2445, në ngarkim të P.P., dosja daton në vitet 1950–1987, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë dhe 3 (tre) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

25. Fondi Operativ, dosje agjenturale nr. 4266, në ngarkim të P.P., dosja daton në vitin 1954, me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

26. Fondi Drejtoria II, dosje personale dhe pune nr. 5018, në ngarkim të E.B., dosja daton në vitet 1984–1988, me 2 volume me 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë dhe 70 (shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

27. Fondi Drejtoria II, dosje personale dhe pune nr. 6001, dosja daton në vitet 1983–1988, me pseudonimin “Horizonti” me 4 volume, me 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë, 232 (dyqind e tridhjetë e dy) fletë, 269 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë dhe 235 (dyqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

KRYETARE
Gentiana Sula

KËRKESË

Nr. 351/7, datë 2.6.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për disa shtesa në VKM- në nr. 769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Unaza Lindore Tiranë, loti III’ shtesat”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë” bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 18,040,988 (tetëmbëdhjetë milionë e dyzet mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



LISTA PARAPRAKE E PRONAREVE QE PREKEN NGA PROJEKTI PËR DISA SHITESA NË VKM-në NR. 769, DATË 20.12.2017, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III’ SHITESAT”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale (m²)	Sip. shprons. truall, arë	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Adresa	Shënime
1	ZENEPE	RESHTI	TAGANI	8170	10/94	TRUALL	580	162	32878	5326236	TIRANË	NË PROCES KONFIRMIMI
	DHURATA	ASLLAN	LUGA									
	SAIMIR	ASLLAN	TAGANI									
	BUJAR	MUHARREM	LUGA									
	LILIANA	MUHAREM	KAZAZI									
	LULJETA	MURAT	NDREÇKA									
	ANDREA	MURAT	PAPA									
	ARJAN	AGIM	TAGANI									
	IRENA	AGIM	SARAÇI									
	KLEDIAN	FATMIR	QEFALLIA									
	GENTIANA	FATMIR	QEFALLIA									
	MUHAMET	FIQIRI	QEFALLIA									
	SUZANA	FIQIRI	QEFALLIA									
	SHPËTIM	FIQIRI	QEFALLIA									
	SHADIJE	HAMID	QEFALLIA									
	BESNIK	HAMDI	QEFALLIA									
	IBRAHIM	HAMDI	QEFALLIA									
	FAIK	ISUF	QEFALLIA									
	EDMIR	ISUF	QEFALLIA									
	SKENDER	JUSUF	QEFALLIA									
	AIDA	SADI	HALILAJ									
	SERVETE	MAHMUT	QEFALLIA									
	ARBEN	SADI	QEFALLIA									
	FATMIRA	ISUF	ÇALI									
2	ZENEPE	RESHTI	TAGANI	8170	10/95	TRUALL	979	384	32878	12625152	TIRANË	NË PROCES KONFIRMIMI
	DHURATA	ASLLAN	LUGA									
	SAIMIR	ASLLAN	TAGANI									
	BUJAR	MUHARREM	LUGA									
	LILIANA	MUHAREM	KAZAZI									
	LULJETA	MURAT	NDREÇKA									
	ANDREA	MURAT	PAPA									
	ARJAN	AGIM	TAGANI									
	IRENA	AGIM	SARAÇI									
	KLEDIAN	FATMIR	QEFALLIA									
	GENTIANA	FATMIR	QEFALLIA									
	MUHAMET	FIQIRI	QEFALLIA									
	SUZANA	FIQIRI	QEFALLIA									
	SHPËTIM	FIQIRI	QEFALLIA									
	SHADIJE	HAMID	QEFALLIA									
	BESNIK	HAMDI	QEFALLIA									
	IBRAHIM	HAMDI	QEFALLIA									
	FAIK	ISUF	QEFALLIA									
	EDMIR	ISUF	QEFALLIA									
	SKENDER	JUSUF	QEFALLIA									
	AIDA	SADI	HALILAJ									
	SERVETE	MAHMUT	QEFALLIA									
	ARBEN	SADI	QEFALLIA									
	FATMIRA	ISUF	ÇALI									
3	DERVISH		SHEHU	3976	184/55	ARË	200	200	448	89600	TIRANË, SHKOZE	Konfirmuar nga ASHK-ja
	SHUMA PARAPRAKE									18040988		

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë